



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:022943

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06212612

Ac.nr.6516/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Fatmir Baloku, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F.T. nga Gjakova, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat F.S. nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, të cilën me autorizim e përfaqëson M.Gj., për kompensimin e shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës të ushtruar nga i autorizuari i paditëses, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.147/2021, të datës 23.05.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 25.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e paditëses F.T. nga Gjakova, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.147/2021, të datës 23.05.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me Aktgjykimin e atakuar ka vendosur si vijon:

“I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses F.T. nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që paditëses në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës, t’ia paguaj shumën prej 355,98 (treqind e pesëdhjetë e pesë euro e nëntëdhjetë e tetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 05.02.2021 (data e paraqitjes së padisë), e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 199,00 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim, në tërësi E PABAZUAR”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i paditëses në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit duke e aprovuar ankesën e të paditurës, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj ashtu që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses sa i përket dy pagave jubilarë, ose të anuloj aktgjykimin ankimor dhe çështjen ta kthej në procedim të sërishëm.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja F.T., nëpërmes të autorizuarit, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar, për 17 vite të përvojës së punës t'ia kompensoj një pagë mujore në shumë prej 355.98 €, duke përfshirë kamatën ligjore prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqës, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit për gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për arsye se sipas vlerësimit të kësaj gjykatë, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë gjendjen faktike, ku edhe janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e tillë të vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, me çka drejtë ka ardhur edhe gjer te aplikimi i të drejtës materiale.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë, pasi që nuk ishte kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura në QKMF Gjakovë-QMF 6-AMF B.Bokës, fakt i vërtetuar me kontratën e punës me numër protokollit 292 të dt.22.03.2012, mirëpo si çështje kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë së paditëses lidhur me kompensimin e një page

jubilare, të cilën paditësja e pretendon me padi, nga e paditura ka qenë parashkrimi i kërkesëpadisë së paditëse, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punë.

Në këtë drejtim edhe Gjykata e Apelit e përkrah mendimin e gjykatës së shkallës së parë të dhënë në aktgjykimin e atakuar, se kërkesëpadia e paditësit është e pathemeltë, duke pas parasysh faktin se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015 dhe ka pasur shtrirje kohore të zbatimit deri me datë 01.01.2018, andaj duke pas parasysh faktin se paditësja padinë e ka ushtruar me datë 05.02.2021, rrjedhimisht gjykata ka vërtetuar se padia e paditëses është paraqitur pas skadimit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Rrjedhimisht të drejtë kjo gjykatë e vlerëson përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë kur e njëjta me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit, në bazë të provave të administruara nuk ka dal e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet refuzuar, ngase edhe kjo gjykatë me shikim në shkresat e lëndës konstaton se paditësi nuk ka mundur ta provojë të drejtën e saj të pretenduar sa i përket themelësisë së kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6516/2022, me datë 25.09.2024

Kryetare e Kolegjit
Naime Ahmeti, d.v.